

RAPORT MONITORIMI

ZBATIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT
TË ÇËSHTJEVE CIVILE/PENALE (CCMIS/ICMIS)
PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË, DURRËS DHE ELBASAN



A.L.T.R.I



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Ky dokument është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (ALTRI) në kuadër të projektit me temë: “Për një zbatim efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS)”, financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS.

Përmbajtja

	Hyrje	5
Vështrim mbi sistemin CCMIS / ICMIS		9
	Kreu I	11
Monitorim i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës dhe Elbasan		
Metodologjia e monitorimit		
Analizimi i të dhënave të mbledhura në kuadër të sondazhit		
Rezultatet e monitorimit		
Konsultimi me aktorët e sistemit të drejtësisë		
	Kreu II	27
Rekomandime		



Hyrje

Në gjykatat shqiptare operojnë aktualisht dy sisteme të ndryshme elektronike për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e zhvillimit të tyre në proces (ARK-IT dhe CCMIS/ICMIS).

Në vitin 2002 është futur në përdorim Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore ARK-IT dhe ndërtimi i rrjetit LAN në 6 Gjykata të Shkallës së Parë (Tiranë, Kavajë, Vlorë, Fier, Shkodër dhe në Gjykatën për Krimet e Rënda). Ky sistem i financuar nga USAID dhe Fondacioni SOROS, realizon regjistrimin e çështjeve, hedhjen e shortit, mbajtjen e procesverbalit, publikimin e vendimeve në faqen e internetit, gjenerimin e statistikave, si dhe ka rezultuar i suksesshëm dhe mjaft efektiv¹.

Në kuadër të modernizimit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore civile në Shqipëri ,duke përfshirë tre nivele gjykatash, (Gjykatat e shkallës së parë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë) në shtator 2006, EURALIUS, në kuadër të Projektit CARDS 2003 (EuropeAid/122786/C/AL)², filloi shpërndarjen e 20 rrjeteve LAN, 20 serverëve, 176 kompjuterëve dhe 46 printërve në rrjet dhe në bashkëpunim me Bashkimin Europian, u parashikua gjithashtu instalimi i Sistemit të Menaxhimit të çështjeve CCMIS në të gjitha gjykatat shqiptare.

¹ Deri në Gusht 2006 në shumicën e gjykatave shqiptare nuk kishte sistem të unifikuar IT dhe as rrjet , 6 nga 38 gjykatave u është siguruar rrjet dhe sistemi i menaxhimit të çështjeve Ark-IT nga Fondacioni SOROS dhe USAID; 3 gjykatave (Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës) u është siguruar rrjet dhe Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve CCMIS nga Banka Botërore. Pjesa tjetër e gjykatave shqiptare nuk kishin as sistem IT, as infrastrukturën e nevojshme për të.

² “Pajisje IT dhe Trajnimi Përkatës për Administratën Gjyqësore”

Versioni i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile (CCMIS), duke përfshirë dhe Çështjet Penale (ICMIS), u instalua në janar 2008. Sistemi mundëson regjistrimin fillestar të çështjeve, hedhjen e shortit duke pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarëve, ndjekjen e çështjes dhe dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera nga momenti i regjistrimit dhe hapjes së dosjes deri në dhënien e vendimit nga gjykata për të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Ky sistem prodhon statistika, akte procedurale si fletë-thirrje etj, duke rregulluar kështu, të gjithë aspektin procedural dhe menaxherial të sistemit gjyqësor.

Zëvendësimi i sistemit ARK-IT me sistemin CCMIS/ICMIS në gjykatat shqiptare vlerësohet nga përfundimet³ e nxjerra nga krahasimi i dy sistemeve, se paraqet avantazhet e mëposhtme:

1. Teknologjia;

Në krahasim me teknologjinë e vjetër të klientit, CCMIS-i ka teknologji më të re dhe më fleksibël, me arkitekturë të bazuar në Web. Ajo mund të lidhet me sisteme të tjera dhe të trajtojë edhe nevojat në të ardhmen.

2. Lidhja në sistem;

Sistemi CCMIS po vepron jo vetëm për Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, por edhe për Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë. Një bazë qendrore të dhënash për të gjitha gjykatat ndodhet në AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

3. Niveli i mbulimit;

ARK-IT është parashikuar të funksionojë vetëm për gjykatat e rretheve gjyqësore, ndërsa CCMIS mbulon të gjitha shkallët gjyqësore. Do të ishte më mirë pasja e një sistemi të unifikuar për të gjitha gjykatat dhe pastaj shtrirja e tij edhe për çështjet penale.

4. Trajnimi;

Sistemi CCMIS është i instaluar në Shkollën e Magjistraturës, në të cilën gjyqtarët e ardhshëm dhe personeli administrativ mund të trajnohet për Sistemin.

5. Mbështetja;

³ "Rekomandim për kompjuterizimin e gjykatave – krahasimi ndërmjet sistemit CCMIS të Bankës Botërore dhe sistemit Ark-it të Usaid-it"

Për CCMIS-in do të jetë një specialist IT në çdo Gjykatë Apeli për të ndihmuar në mirëmbajtjen e Sistemit dhe t'u sigurojë mbështetje përdoruesve.

6. Çmimi;

CCMIS-i është në pronësi të Qeverisë Shqiptare. Nuk ka nevojë të paguhet tarifa për licencën dhe nuk krijohet varësi nga ndonjë kompani e caktuar.

7. Pajisjet fizike.

Bashkimi Europian e mbështet Sistemin CCMIS me kompjutera dhe servera.

Aktualisht, sistemi ARK-IT është në përdorim ende në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Krimeve të Rënda për disa arsye teknike të sistemit CCMIS/ICMIS, ndërsa në të gjitha gjykatat e tjera, si dhe në Gjykatën e Lartë është në përdorim Sistemi CCMIS/ICMIS.



4 Vështrim mbi sistemin CCMIS / ICMIS

Sistemi CCMIS/ICMIS është i instaluar në një server dhe që funksionon nëpërmjet shfletuesit të internetit (internet browser), që shfrytëzohet nëpërmjet një kompjuteri. Ai përfshin lidhjen e çështjeve të shkallës së parë deri në Gjykatën e Lartë, që do të thotë se çështjet mund të kërkohen dhe shikohen në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore edhe pasi të kenë kaluar në Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë.

Sistemi CCMIS/ICMIS⁵ ofron funksionalitetet e tij sipas profileve dhe hierarkisë së përdoruesve. Ai është i aksesueshëm vetëm nga përdoruesit e autorizuar, duke përfshirë të gjithë punonjësit e gjykatës që janë regjistruar në program dhe që i është caktuar një Kod Përdoruesi dhe një Fjalëkalim.

Sistemi lejon menaxhimin e përdoruesve sipas të drejtave të përdorimit, për rolet e caktuara në aplikacionin CCMIS/ICMIS (Sekretar Regjistruar, Krye/sekretare, nëpunës gjyqësor, gjyqtar, Kancelar, Kryetar, Administrator), identifikimin e punonjësve që hyjnë në sistem, hedhjen e informacioneve fillestare që përfshijnë kategoritë e çështjeve, llojet, mjetet e ankimit etj, të cilave u referohen gjatë punës për regjistrimin e çështjes, menaxhimin e të dhënave të Punonjësve, Ekspertëve, ditëve të pushimit, hedhjen e të dhënave për lejet e punonjësve etj.

Sistemi mundëson dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera nga momenti i regjistrimit të çështjes dhe hapjes së dosjes, deri në dhënien e vendimit nga gjykata për të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

⁴ Projekt i financuar nga Banka Botërore në kuadër të modernizimit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë.

⁵ Manuali i parë shqip nga Kompania Datech, e specializuar dhe e kontraktuar për informatizimin e sistemit gjyqësor shqiptar.

SISTEMI INFORMATIK I MANAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE			
Regjistrimi	Procedimi i Çështjes	Arkiva	Manaxhimi i Gjykatës
Çështje e Re Civile Çështje e Re Penale Informacion mbi Çështjen Të dhënat e Palëve Vendime të Mëparëshme Dokumentat e Çështjes Provat Tarifat Kontrolli i Dosjes GMÇ dhe Trupat Gjyqësues Planifikimi	Penale Themeli Penale Themeli Ushtarake Kërkesë Penale Kërkesë me të Dëmtuar Akuzues Masë Sigurimi	Përshkrim i Punës Data e Marrjes Nr. i Çështjes	nllazi Filtra Muaji i fundit Pamje

Të gjitha çështjet e regjistruara i nënshtrohen shortit elektronik në dritaren e kryetarit, duke mbajtur në konsideratë parimin e shpërndarjes së barabartë të çështjeve, si dhe duke parashikuar kategorizimin e çështjeve, në mënyrë sa më të njëtrajtshme.

Në shpërndarjen rastësore, çështjet i ngarkohen grupit që merret me procedurat deri në mbylljen e çështjes, Grupit të Menaxhimit të Çështjes (GMÇ), që përbëhet nga Gjyqtari dhe një Sekretar/e.

Tipare të tjera të këtij sistemi janë regjistrimet e veprimeve, regjistrimi i detyrave të punës nga gjyqtarët që kryesojnë Ekipin e Menaxhimit të Çështjeve, ndjekja e ndryshimeve të regjistrimeve, me qëllim që të shihet se kush i ka bërë ndryshimet në regjistër, një gjenerim automatik të një “*audit log*” që mund të ndjekë ndryshimet e mëparshme të çdo dosjeje të çështjeve dhe një “*menaxhim automatik të fluksit të punës*”. Pra regjistri i veprimeve ose RIV paraqet një listë me veprimtaritë, të cilat kanë ndodhur në një çështje të caktuar.

Sistemi është ndërtuar posaçërisht për t’iu përgjigjur rrethanave shqiptare dhe kështu ai lejon gjenerimin automatikisht të raporteve në formën e dëshiruar nga gjykatat dhe Ministria e Drejtësisë, për qëllimet e tyre përkatëse statistikore.

Një shpjegim më të detajuar mbi mënyrën se si Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Civile/Penale i trajton procedurat e gjykatave në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe ato të Apelit në Shqipëri do t’i gjeni në manualët: “*Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Çështjeve Civile (CCMIS)*”, *Ndryshimet në versionin 5.0 të sistemit CCMIS/ICMIS*⁶.

⁶ Krijuar nga Kompania Ikubinfo, gjatë viti 2011 për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e moduleve të reja software.

Kreu I

Monitorim i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës dhe Elbasan

Monitorimi i sistemit CCMIS/ICMIS synonte një vlerësim të drejtpërdrejtë të zbatimit të tij në praktikë në tre Gjykata: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Qëllimi i këtij procesi monitorimi ishte evidentimi i problematikës në përdorimin/mospërdorimin e këtij sistemi, si dhe identifikimi i përmirësimeve teknike dhe ligjore të nevojshme për të siguruar funksionimin e plotë të tij.

Në kuadër të procesit të monitorimit u hartuan pyetësorë të ndryshëm, në varësi të pozicionit të punës dhe kompetencave të subjektit që i drejtohej (Kryetar/e i gjykatës, Gjyqëtar/e, Kancelar/e, Kryesekretar/e dhe Sekretar/e gjyqësor) dhe të mënyrës së përfshirjes së tij në këtë sistem.

A. Metodologjia e monitorimit

Metodologjia që u zbatua, u ideua në mënyrë të tillë që të siguronte arritjen e rezultateve konkrete në përmbushjen e objektivave të propozuar. Kjo iniciativë u perceptua të mbështetet mbi dy shtylla apo aktivitete kryesore, ku secili prej tyre përbëhej nga nënaktivitetet përkatëse. Këto aktivitete u fokusuan në:

- (i) monitorimin e Sistemit CCMIS/ICMIS;
- (ii) konsultimi me aktorët e sistemit të drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile.

Më poshtë do të detajojmë dy nga nën aktivitetet më të rëndësishme, të ndërmarra gjatë zbatimit të projektit. Më konkretisht: monitorimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe zhvillimin e takimeve me karakter konsultues.

B. Analizimi i të dhënave të mbledhura në kuadër të sondazhit

Nga analiza e sondazheve/pyetësorëve bazuar në gjykimin e secilit përdorues; (i) nëpunësit gjyqësor; (ii) sekretar gjyqësor; (iii) kancelarë; (iv) kryetarët e gjykatave; (v) gjyqtar, Qendra e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale ka mbledhur të dhëna mbi funksionimin dhe përdorimin e Sistemit CCMIS/ICMIS në tre Gjykatat: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Tabela e mëposhtme përmbledh totalin e të dhënave për tre Gjykatat në lidhje me pyetësorët e plotësuar si më poshtë vijon:


- Kryetar 3 (tre)
- Kancelar 3 (tre)
- Gjyqtar 3 (tre)
- Kryesekretar 3 (tre)
- Nëpunës Gjyqësor 15 (pesëmbëdhjetë)

	Po	Jo	I pjesshëm	Pa përgjigje
Për një zbatim efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS)				
A përdoret sistemi CCMIS/ICMIS në gjykatën tuaj? <i>Komente:</i> <ul style="list-style-type: none"> - Jo, për shkak të problemeve të shumta që u hasën gjatë testimit të sistemit CCMIS/ICMIS pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vetëm për seksionin familjar dhe mos rregullimit të tyre; - Sistemi nuk ofron të gjitha shërbimet e domosdoshme të punës në Gjykatën e Tiranës, nuk gjeneron statistika dhe nuk publikon informacion të saktë dhe të plotë për publikun; - Transferimi i arkivës së çështjeve nga sistemi ARK-IT në sistemin CCMIS/ICMIS. 	22	4		1
Stafi ka nevojë për trajnime shtesë për të rritur cilësinë e përdorimit të sistemit? <i>Komente:</i> <ul style="list-style-type: none"> - Po, kjo për arsye se ndryshimet e reja në sistem nuk paraqiten pranë gjykatës nëpërmjet një manuali me qëllim mundësimin e informimit të stafit; - Ose për përditësimet e reja në sistem firma duhet të trajnojë/njoftojë specialistin e IT. 	5	10	7	5

	Po	Jo	I pjeshëm	Pa përgjigje
<p>A është sistemi në përputhje me procedurat nga legjislatiioni në fuqi?</p> <p><i>Komente:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkesa në dhomën penale nuk është e barabartë, kjo për arsye se sistemi parashikon ngarkesë për masat e sigurimit; - Sistemi nuk gjeneron dhe printon vërtetimin e regjistrimit të çështjes në rastet kur kërkohet nga pala; - Nuk regjistrohen në sistem të dhënat për çështjet penale për llojin e dënimit: dënim me burg + gjobë dënim alternativ; - Statistikat. 	11	1	10	5
<p>A lehtëson sistemi punën e përditshme sipas roleve në sistem?</p> <p><i>Komente:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesërisht, është i avashtë, dhe kompleks në përdorimin e tij, duhen mbi 5 klikime për të arritur në rezultatin e kërkuar. - Për sa i përket aktivitetit të zyrës së Kryesekretarisë ky sistem nuk e ka lehtësuar punën. Është punë e dyfishtë nga njëra anë regjistrimi elektronik dhe nga ana tjetër ai fizik, regjistrat elektronik dhe ata fizik, mos përputhja midis tyre sjell gjenerim jo të saktë të statistikave; - Për sekretarin regjistruar të çështjeve në sistem duhet shtuar objekte të tjera në lidhje me çështjen dhe duhet azhurnuar pjesa e neneve për çështjet penale, të cilat pengojnë regjistrimin e saktë të çështjes; - Në lidhje me nëpunësin gjyqësor, është thjeshtuar procedura e mbajtjes së seancave dhe mënyra e menaxhimit të tyre është më e lehtë nëpërmjet sistemit, pengesë janë mos gjenerimi automatik i akteve për një çështje (Fletëthirje, Njoftim me Shpallje, Njoftim Vendimi me shpallje), gjithashtu është shtuar dhe hedhja e të dhënave në dritaren e gjyqtarit si pasojë e mospërdorimit të sistemit nga ana e tyre. 	4	8	9	6
<p>A mundëson sistemi administrimin e të dhënave sipas pozicionit tuaj në gjykatë?</p> <p><i>Komente:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi ka lehtësuar administrimin e një pjese të të dhënave por nevojiten përmirësime në administrimin dhe gjenerimin e të dhënave në lidhje me çështjen për kancelarin dhe zyrën e kryesekretarisë. 	7		19	1

	Po	Jo	I pjesshëm	Pa përgjigje
A ka nevojë sistemi për përmirësime të mëtejshme?	22	1	1	3
Është e nevojshme hartimi i akteve/ rregulloreve për përdorimin e sistemit në Gjykata? <i>Komente: Është i nevojshëm hartimi i një rregulloreje pasi do të përcaktonte detyrat për çdo përdorues dhe hedhjen e saktë të të dhënave duke çuar më pas dhe në gjenerimin e saktë dhe të statistikave.</i>	8	4	6	9
A gjeneron sistemi statistika sipas formateve standarde të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë? <i>Komente: Sistemi për arsye të problematikave që ai ka nuk gjeneron statistika të sakta, përmirësime duhen dhe në gjenerimin e statistikave për gjykatën.</i>	1	12	1	13

Grafiku i të dhënave të mbledhura në kuadër të sondazhit



	A përdoret sistemi cmis/acnis në gjykatën tuaj?	Stafi ka nevojë për trajnime shtesë për të rritur cilësinë e përdorimit të sistemit?	A është sistemi në përputhje me procedurat nga legjislativi në fuqi?	A lehtëson sistemi punën e përditshme sipas roleve në sistem?	A mundëson sistemi administrimin e të dhënave sipas pozicionit tuaj në gjykatë?	A ka nevojë sistemi për përmirësime të mëtejshme?	Është e nevojshme hartimi i akteve/rregulloreve e për përdorimin e sistemit në Gjykata?	A gjeneron sistemi statistika për Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë?
■ Po	22	5	11	4	7	22	8	1
■ Jo	4	10	1	8	19	1	4	12
■ I pjesshëm		7	10	9	1	6	1	
■ Pa përgjigje	1	5	5	6	1	3	9	13

C. Rezultatet e monitorimit

■ Evidentimi i problematikave gjatë aplikimit në praktikë të sistemit CCMIS/ICMIS.

Kjo u realizua përmes monitorimit sistematik të veprimtarisë së gjykatave që janë subjekt vëzhgimi, nga ekspertët e organizatës, të cilët kanë ndjekur në mënyrë të drejtpërdrejtë aplikimin në praktikë të sistemit gjatë një dite normale të punës si dhe janë zhvilluar dhe intervista apo bisedime me punonjësit të cilët aplikojnë këtë sistem.

Për sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë përdor ende sistemin ARK-IT, por evidentimi i problematikave për këtë gjykatë është realizuar nëpërmjet analizimit të listës së problematikave të nxjerra gjatë implementimit të sistemit në mars të vitit 2011 deri në dhjetor 2011, vetëm për çështjet familjare.

Më poshtë gjendet lista e problematikave të evidentuara, nëpërmjet monitorimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, të aplikimit në praktikë të sistemit, gjatë një dite normale pune:

• Përshtatja e sistemit me ndryshimet në legjislacionin penal

Në fazën e regjistrimit të çështjes penale vërehet se menuja në sistem “*Lloji i Çështjes*” nuk është përditësuar me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal.

• Përfshirja e gjyqtarit që ka dhënë masën e sigurimit

Sistemi duhet të lejojë gjatë regjistrimit të një çështjeje penale themeli, përfshirjen nga shorti të gjyqtarit që ka dhënë masën e sigurimit për këtë çështje me qëllim ndarjen e barabartë të çështjeve midis gjyqtarëve nga shorti elektronik.

• Komunikimi me sistemet e tjera

Gjatë regjistrimit të një çështjeje në gjykatë, u diskutua se komunikimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve CCMIS/ICMIS me sisteme të tjera, do të shkurtonte jo vetëm kohën për regjistrimin e të dhënave të nevojshme për çështjen, por do të sillte edhe saktësimin e tyre;

- me Sistemin e Prokurorisë
- me Sistemin e Përmbartimit ALBIS (Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Përmbartimore) për sa i përket urdhrave të ekzekutimit;
- me Sistemin e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile⁷ ;
- me Sistemin e Regjistrimit Kombëtar të Adresave⁸.

⁶ Komunikimi me sistemin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile do të minimizojë veprimet në sistem për regjistrimin e të dhënave të personave që janë pjesë e një procesi gjyqësor.

⁸ Komunikimi i sistemit CCMIS/ICMIS me Regjistrimin Kombëtar të Adresave do të shmangete thirrjet jo të suksesshme të pjesëmarrësve në gjykim, shkak i vazhdueshëm i shtyrjes së seancave dhe si rrjedhojë rrit në mënyrë të panevojshme kohëzgjatjen e proceseve.

- **Regjistrimi - Me pak veprime për regjistrimin e çështjes**

Fillimisht janë 2-3 hapa që duhen bërë në sistem për të nisur me regjistrimin e çështjes. Për shkak të volumit të madh të punës, është e nevojshme që disa prej këtyre hapave të eliminohen, duke shkurtuar në këtë mënyrë kohën që i duhet përdoruesit për të regjistruar një çështje.

- **Mospërdorimi i fletëthirrjeve të gjeneruara nga sistemi CCMIS/ICMIS**

Sistemi CCMIS/ICMIS gjeneron fletëthirrjet duke pasur parasysh parashikimin ligjor në nenin 132 KPP dhe 128 e vijues të KPC. Por gjenerimi dhe printimi i tyre nuk bëhet nga sistemi, sipas përdoruesit sekretar gjyqësor, kjo për arsye se duhen bërë mbi 3 hapa deri në gjenerimin dhe printimin e fletëthirrjes për çdo çështje. Prandaj është i nevojshëm të bëhet reduktimi i hapave që të çojnë në gjenerimin e fletëthirrjes, për të përshpejtuar punë në sistem.

- **Planifikimi i seancave**

Aktualisht planifikimi bëhet vetëm nga dritarja e gjyqtarit të çështjes, por meqë gjyqtarët nuk përdorin sistemin, duhet të shikohet mundësia e planifikimit të seancave edhe nga sekretarja e gjyqtarit, në mënyrë që të lehtësohet puna e sekretareve gjyqësore me sistemin.

- **Njoftimi i palëve në një proces gjyqësor nëpërmjet komunikimeve elektronike⁹**

Për një administrim sa më të mirë të proceseve gjyqësore, duhet të krijohet mundësia e modulit të njoftimit elektronik të palëve që duhet të njoftohen për seancat gjyqësore siç janë p.sh.: adresat elektronike, thirrjet telefonike apo nëpërmjet një mesazhi të shkruar në telefon.

- **Regjistrimi - Ankimi/Rekursi**

Sistemi nuk duhet të lejojë regjistrimin e ankimeve/rekurseve nga kryesekretarja edhe pas kalimit të afatit ligjor, për arsye se ky veprim ndikon në gjenerimin jo të saktë të statistikave.

- **Ankimimet – zgjedhja e numrit të çështjes që ankimohet**

Është shumë e vështirë të gjendet dhe të përzgjidhet saktë numri i dosjes, për të cilin po bëhet ankimi në momentin e regjistrimit të tij në ICMIS. Të shikohet

⁹ Referoju ndryshimeve të fundit në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, për ndryshimet e rregullave mbi njoftimin e palëve nëpërmjet përfshirjes së mënyrave të reja të komunikimeve elektronike.

mundësia e shkurtimit të kësaj liste, ose e kërkimit të numrit të çështjes dhe më pas shfaqjes së çështjes përkatëse (numër, datë, titull, palë) për të cilën po regjistrohet ankimimi.

- **Gjenerimi i Buletinit**

Sistemi nuk gjeneron të dhëna për plotësimin e buletinit penal për personat e dënuar, i cili i dërgohet Zyrës së Gjendjes Gjyqësore menjëherë sa vendimi merr formë të prerë.

- **Mbartja e çështjeve**

Problematikë tjetër është moskorrespondenca e statusit të çështjeve në regjistrat fizik me atë në sistem, pra nëse në regjistrin manual kjo çështje nuk është e mbyllur dhe duhet të mbartet, rezulton që në sistem të jetë e mbyllur. Për të shmangur problemet e mësipërme është e nevojshme hartimi i një rregulloreje për plotësimin e saktë të të dhënave nga përdoruesit.

Gjithashtu në lidhje me procesin e mbartjes në sistemin ICMIS u evidentua si problematikë që sistemi nuk realizon mbartjen e çështjeve para një viti, nëse çështja është që në 2008, sistemi nuk e mbart.

- **Arkiva elektronike e dosjeve gjyqësore**

Sistemi nuk ka një arkivim të mirëfilltë elektronik të dosjeve gjyqësore. Arkiva përmban edhe çështjet që janë në proces. Gjithashtu sistemi nuk lejon kërkim të detajuar dhe gjurmueshmërinë sipas nivelit të gjykimit.

- **Gjenerimi: Statistika të pasakta¹⁰**

Sistemi nuk gjeneron statistika sipas formateve standarde të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu duhen bërë përmirësime në gjenerimin e raporteve statistikore të gjykatës p.sh: gjenerimi i statistikave sipas një objekti të caktuar (për të dhënat e dhunës në familje të cilat gjenerohen nga çështjet me objekt lëshim urdhër mbrojtje), sipas një kategorie të caktuar për çështjet civile dhe sipas ndarjes në grupe për veprat penale.

- **Gjenerimi i regjistrave jo i njëjtë me regjistrat manual**

Aktualisht sistemi gjeneron vetëm regjistrat bazë për çështjet e regjistruara civile dhe penale;

- Regjistri i çështjeve civile themeli;
- Regjistri i kërkesave civile;

¹⁰ Problematikë kjo e identifikuar dhe në të gjithë pyetësorët e plotësuar nga përdoruesit

- Regjistri i urdhrave të ekzekutimit për çështjet civile;
- Regjistri i çështjeve penale themeli;
- Regjistri i çështjeve penale themeli ushtarake;
- Regjistri i kërkesave penale;
- Regjistri i kërkesave me të dëmtuar akuzues;
- Regjistri i masave të sigurimit.

Ndërkohë që Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore parashikon dhe regjistra të tjerë, që duhet të mbajë sekretaria e gjykatës, përveç regjistrave bazë për çështjet e regjistruara civile dhe penale që gjeneron sistemi. Vetëm në këtë mënyrë, sistemi i regjistrimit të çështjeve do të pasqyronte saktësisht dhe besueshmërisht përmbajtjen e sistemit manual të regjistrimit.

• **Indeksi i vendimeve/mënyra e shfaqjes në sistem**

Gjithashtu të përmirësohet gjenerimi i indeksit/regjistrin të vendimeve dhe mënyra e kërkimit që mundëson shfaqjen e emrit të gjyqtarit në krah të çështjes, si edhe datën dhe numrin e vendimit, në mënyrë që të shmangen veprimet e tepërta për të parë këtë informacion (cili gjyqtar gjykon çështjen dhe nëse ka dhënë vendimin për çështjen) duke hapur çështjen dhe të dhënat e saj.

• **Transferimi i çështjes në mënyrë elektronike nga një gjykatë në tjetrën**

Për të transferuar një dosje nga një gjykatë në një tjetër ekziston në sistem opsioni “*Eksport*” në menu-në “*Administrim veprimi*” i cili kryhet nga sekretari regjistruar, por aktualisht gjykatat e tre niveleve nuk shkëmbejnë informacion mes tyre.

■ **Aplikimi i Sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio (RDA) në gjykata**

Në kuadër të dixhitalizimit të sistemit gjyqësor, prezantimi i një teknologjie të fjalës së fundit RDA (Regjistrimi Dixhital Audio¹¹) përbën një ndryshim thelbësor në mënyrën se si zhvillohen seancat gjyqësore, si dhe një hap të madh përpara për sa i përket transparencës dhe procesit të rregullt ligjor në Shqipëri.


Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio (RDA), i shtrirë në gjykatat shqiptare falë mbështetjes së USAID-it, mundëson regjistrimin e të gjithë komunikimit verbal që ndodh gjatë seancave gjyqësore. Seancat gjyqësore regjistrohen me lehtësi dhe gjatë tyre mund të mbahen edhe shënime nga sekretari gjyqësor. Regjistrimi audio lidhet gjithashtu automatikisht me datën dhe vendin e zhvillimit të seancës. Zëri i gjykatësit, i

11 Regjistrimi Dixhital Audio në Gjykata (RDA) është nismë e mbështetur nga Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST).

palëve ndërgjyqëse dhe/ose përfaqësuesve të tyre, si dhe i dëshmitarit regjistrohet në kanale të veçanta dhe të gjitha regjistrimet ruhen në serverin e sistemit CCMIS/ICMIS, në përputhje me protokolle të caktuara që sigurojnë integritetin dhe arkivimin e tyre.

Regjistrimi audio i seancave përfshihet në dosjen e çështjes gjyqësore, gjithashtu ato mund të ridëgjohen si dhe të kopjohen lehtësisht në CD/DVD, sipas nevojës.

Kërkesa për kopje të regjistrimit audio¹² është i njëjtë për të gjitha gjykatat dhe paraqitet përmes plotësimit të një formulari përkatës, i cili gjendet pranë sekretarisë apo sportelit të shërbimit të gjykatës.



Kjo nismë teknologjike për rritjen e transparencës, efektshmërisë dhe përgjegjshmërisë në sistemin gjyqësor është zbatuar tashmë në më shumë se dy të tretat e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit. E filluar me instalimin pilot në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në mars 2012 dhe më tej e shtrirë në të gjitha gjykatat e përfshira në rang apeli në Korçë, Durrës, Tiranë dhe Vlorë, si dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Krime të Rënda, tani puna për zbatimin e teknologjisë RDA po vazhdon në gjykatat brenda kompetencës territoriale të apelit Shkodër dhe Gjirokastrë.

Përdorimi i teknologjisë RDA¹³ për mbajtjen e procesverbalit të seancave gjyqësore parashikohet në Kodin e Procedurës Penale si dhe në ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile (Ligji

¹² "Mbi kërkesën për kopjet RDA", të hartuar me mbështetjen e projektit JuSt të USAID-it, dhjetor 2013.

¹³ Pyetje – Përgjigje mbi sistemin e regjistrimit dixhital audio për gjykatat në Shqipëri" hartuar nga Projekti JuSt i USAID-it, shkurt 2014

nr. 122/2013 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 67, datë 3 maj 2013), si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Drejtësisë nr. 353, datë 3 shtator 2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

Gjithashtu Projekti JuST ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë për të krijuar një nivel bazë integrimi të sistemit RDA me sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (CCMIS/ICMIS), duke bërë të mundur që procesi i regjistrimit të nisët nga dosja elektronike e çështjes në ICMIS.

Integrimi i sistemit RDA në sistemin CCMIS/ICMIS

Nga monitorimi i ekspertit të qendrës në lidhje me integrimin e sistemit RDA me sistemin (CCMIS/ICMIS), u vërtetua realisht hapja e RDA nga sistemi CCMIS/ICMIS.

Integrimi midis dy sistemeve është bazik dhe mundëson komandimin e fillimit të regjistrimit në FTR nëpërmjet një butoni në dritaren e procesverbalit në CCMIS/ICMIS për të lehtësuar veprimet fillestare të sekretarit gjyqësor në një ndërfaqe të vetme.

Për sa i përket shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemit CCMIS/ICMIS dhe FTR, integrimi bën të mundur krijimin e një liste të regjistrimeve (log list) në CCMIS/ICMIS që bën të mundur lidhjen me regjistrimin audio të një seance të caktuar nga vetë sistemi ICMIS. Ndërsa fleta e shënimeve në sistemin RDA nuk mund të marrë automatikisht të dhëna nga CCMIS/ICMIS, si për shembull numrin e çështjes. Në këto kushte sekretari gjyqësor duhet të kopjojë manualisht (me anë të komandës copy & paste) numrin e plotë të çështjes nga sistemi CCMIS/ICMIS dhe ta vendosë atë në fushën e përshkrimit. Kjo bën të mundur që regjistrimi audio të identifikohet me çështjen konkrete.

Nga monitorimi u vu re që në shumicën e rasteve, nga ana e sekretarëve gjyqësorë, fillimi i regjistrimit audio në sistemin RDA nuk komandohet nga sistemi CCMIS/ICMIS, por punohet direkt nga aplikacioni FTR Recorder.

Për sa më sipër sugjerohet përmirësimi i integritit të RDA me sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (CCMIS/ICMIS) dhe shkëmbimit të informacionit midis dy sistemeve për lehtësimin dhe efektshmërinë e punës në gjykata.

Gjithashtu arkiva e regjistrimeve dixhitale audio të mos ruhet në serverin e sistemit CCMIS/ICMIS, për arsye të ngarkesës, por të krijohet një data server qendror dedikuar vetëm për replikimin dhe arkivimin e këtyre fileve audio që krijohen në gjykata.

■ **Përmirësime të tjera në sistemin CCMIS/ICMIS**

1. Portali on-line i gjykatave

Përveç implementimit të sistemit në gjykatat e Shqipërisë, është dizenuar dhe portali publik i gjykatave, i cili menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë dhe aksesohet në linkun www.gjykata.gov.al. dhe prej tij mund të navigohet në portalet e secilës prej gjykatave të Shqipërisë, përmbajtja e të cilëve menaxhohet nga specialistët IT të secilës gjykatë.

Ky portal, pjesë e projektit të dixhitalizimit të sistemit të drejtësisë, synon nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne, përmirësimin e shërbimit administrativ dhe procedural në Gjykata, në kuadër të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve.

Portali online i Gjykatave shqiptare, është i përbërë nga 32 website. Gjykata e Lartë, çdo gjykatë Apeli, çdo gjykatë e shkallës së parë, ka website-in e saj në këtë portal, në të cilin gjendet informacion i personalizuar për atë Gjykatë.



Gjatë navigimit nga vetë ekspertët e qendrës në portalin publik të gjykatave <http://gjykata.gov.al> u konstatua se duhen bërë përmirësime për sa më poshtë:

- Portali nuk ofron informacion të plotë mbi veprimtarinë e gjykatës, mbi procedurat e gjykatës (si ngrihet një kërkesë padi, ankimi, rekursi, tarifa gjyqësore..etj).
- Portali nuk ofron informacion mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore sipas mënyrës së përfundimit (Shkalla e parë, Apel, Gjykatë e Lartë).

- Mënyra e kërkimit në këtë portal për marrjen e informacionit është e komplikuar. Duhet të kryhen shumë veprime për të marrë të dhëna të sakta mbi çështjen, kalendarin e seancave, informacion mbi shortin. Duhet shtuar kërkimi tek nënmenuja “*Kalendari i seancës*” sipas emrit të palës. Krijimi i broshurave në lidhje me mënyrën e kërkimit në portal, me qëllim marrjen e informacionit lehtësisht, në mënyrë të shpejtë dhe të saktë, duke synuar rritjen e besueshmërisë së publikut në gjyqësor do të ishte me interes.
- Nuk është respektuar publikimi i vendimeve sipas Udhëzimit nr.15, datë 23.12.2011 “*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*”, ku gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur për çështjen në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.

2. Inspektimi online për inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë në sistemin CCMIS/ICMIS

Në kuadër të dixhitalizimit të sistemit gjyqësor dhe sipas nenit 6, ligjit Nr. 8678, datë 14. 5. 2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë*” sugjerojmë se krijimi i inspektimit online¹⁴ për inspektorët pranë Ministrisë së Drejtësisë do të sillte reduktimin në kohë dhe në kosto të raportimit mbi kontrollin e inspektimeve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, lidhur me çështje të objektivitetit të inspektimit (në rastet kur këto të fundit mund të kontrollohen dhe në mënyrë on-line në sistem).

Në këto kushte nga ana teknike nevojitet të krijohet mundësia e ndërtimit të strukturës dhe krijimin e përdoruesve që kanë akses në kontrollin e çështjeve në sistemin qendror, duke lejuar përdoruesin inspektor të identifikojë çështjet e caktuara për inspektim dhe informacionet shoqëruese, si dhe të njoftojë në mënyrë automatike e të jenë vizualisht të dallueshme shkeljet e afateve të çështjeve të gjykuara për strukturat përkatëse.

Sistemit duhet të ofrojë një modul të instaluar në Ministri, i cili kryen leximin e të dhënave të çështjeve për çdo gjykatë. Ky modul duhet të jetë i aksesueshem për përdorues në rolin e inspektorit, i cili nuk duhet të ofrojë ndryshim të të dhënave, ato shfaqen vetëm për lexim.

3. Gjenerimi i statistikave në nivel gjykatash për Ministrinë e Drejtësisë

Sipas rregullores së brendshme “*Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë*”, sektorit i statistikave pranë Ministrisë së Drejtësisë ka në objekt

¹⁴ E njëjta logjikë të ndiqet dhe për krijimin e përdoruesit inspektorët pranë KLD në sistemin CCMIS/ICMIS.

të punës mbikëqyrjen, grumbullimin, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore të unifikuara procedurale, administrative, hetimore dhe gjyqësore si dhe për metodikën dhe mënyrën e mbajtjes së statistikës gjyqësore, penale dhe civile.

Nga ana teknike, sugjerohet krijimi i një moduli të instaluar pranë Ministrisë së Drejtësisë, për përdoruesin (Specialistin) e Statistikave pranë këtij institucioni, i cili do të ofrojë marrjen në mënyrë elektronike të statistikave për çdo gjykatë dhe në rang gjykatash sipas periudhave standarte kohore të caktuara nga Ministria e Drejtësisë. Gjenerimi i tyre të bëhet i mundur dhe në formatin Excel, për t'i dhënë mundësi këtij përdoruesi për përpunimin e të dhënave dhe sipas kërkesave të tjera.

Ndërkohë nga projekti JuST i USAID-it është ndërtuar Programi Kompjuterik për Administrimin e Kalendarit të Seancave Gjyqësore dhe Raportimin e Përdorimit të Sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio (RDA), i njohur shkurt si PAKS+. Ai i vjen në ndihmë gjykatave në lehtësimin e planifikimit të seancave gjyqësore dhe raportimin statistikor për përdorimin e sistemit RDA. PAKS + merr të dhëna në mënyrë automatike nga ICMIS dhe sistemi RDA dhe instalohet në serverin e gjykatës. Ai aksesohet si nga gjyqtarët, ashtu si edhe nga i gjithë personeli i gjykatës. PAKS + nuk kërkon që të kryhen veprime të posaçme dhe mbështetet në veprimet e planifikimit të seancave që janë kryer më parë në ICMIS dhe mbajtjen e procesverbalit audio në sistemin RDA. Deri në fund të muajit shkurt 2014, PAKS + ishte instaluar dhe funksiononte në 22 gjykata në vend.

D. Konsultimi me aktorët e sistemit të drejtësisë

Në kuadër fazës së dytë të projektit ishte parashikuar zhvillimi i takimeve konsultuese me aktorët e sistemit të drejtësisë si: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit në të gjithë vendin. Qendra organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrës të gjithë këta aktorë, me qëllim konsultimin e përfundimeve të arritura nga procesi i monitorimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile /Penale, si dhe sigurimin e mendimeve të tyre, në funksion të përmirësimit të Sistemit.

Pas prezantimit të qëllimit, objektivave, metodologjisë së përdorur gjatë zbatimit të projektit dhe gjetjeve të evidentuara nga monitorimi së bashku me rekomandimet e Qendrës, aktorët e sistemit të drejtësisë diskutuan mbi rezultatet e procesit të monitorimit dhe dhanë rekomandimet e tyre përkatëse. Në funksion

të pasqyrimin sa më të saktë dhe të plotë të rekomandimeve të tyre, u kërkua përcjellja e sugjerimeve të tjera edhe pas takimit konsultues.

Më poshtë po detajojmë diskutimet dhe rekomandimet e dhëna nga këta aktorë, në kuadër të evidentimit të hapave përmirësuese të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS).

- **Hartimi i një rregulloreje për përdorimin e sistemit**

U diskutua domosdoshmëria e hartimit të një rregulloreje të posacme për përdorimin e sistemit, për shkak të ekzistencës së një manuali aktual të karakterit teknik, i cili ka nevojë për t'u shoqëruar me një rregullore të tillë, që të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo përdorues.

- **Trajnimi i IT-ve**

Trajnimi i IT-ve, u vlerësua si një element, i cili do t'i - shërbejë më së miri Sistemit. Më konkretisht u rekomandua se nevojitet trajnimi i IT-ve për ndryshimet/përmirësimet në sistemin CCMIS dhe ICMIS. Gjithashtu do të ishte i nevojshëm edhe një raportim javor i IT-ve të gjykatave pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim përcjelljen e shqetësimeve për problemet teknike të hasura gjatë javës në përdorimin e Sistemit. Ky raportim do të ndihmonte në zbatimin më me efektivitet të Sistemit. Edhe takimet konsultuese midis IT, pse jo dhe me aktorë të tjerë që përdorin sistemin, do të ishte me interes jo vetëm në evidentimin e problematikave, por edhe shkëmbimin e eksperiencave midis tyre.

- **Transferimi i çështjes në mënyrë elektronike nga gjykata e shkallës së parë në apel dhe në Gjykatë të Lartë**

Megjithëse ekziston teknikisht, vazhdon të mbetet jo funksional transferimi i çështjeve në gjykata. Specialistët IT të gjykatave konfirmuan se një opsion i tillë gjatë aplikimit nga ana e tyre në praktikë nuk ka funksionuar. Prandaj është i nevojshëm të ndërhyhet për t'u bërë i përdorshëm ky opsion.

- **Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të fillojë funksionimin e sistemit CCMIS/ICMIS**

Referuar Gjykatës së Tiranës, e cila aktualisht punon ende me sistemin ARK-IT, u diskutuan arsyet e mospërdorimit të sistemit të ri.

1. Gjykata e Tiranës ka testuar sistemin CCMIS dhe ICMIS gjatë periudhës mars - dhjetor 2011, vetëm për seksionin familjar. Gjatë përdorimit të sistemit nga kjo gjykatë u pa se kishte probleme me: numërtimin e çështjeve jo sipas regjistrave fizik, indeksin e vendimeve, statistikave, etj.
2. Për shkak të volumit të madh të kërkesëpadive që dorëzohen në Gjykatën e Tiranës, është e pamundur të regjistrohen të gjitha kërkesëpaditë që dorëzohen brenda 1 dite. Kërkesëpaditë e dorëzuara një ditë më parë, mbeteshin për ditën e nesërme për t'u hedhur në sistem, pasi ishte e pamundur që të realizohej brenda 1 dite pune.
3. Përveç kësaj, problematikë shihej çështja e transferimit në ICMIS e të gjithë database-it të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që nga viti 2002.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, propozoi që kjo problematikë mund të zgjidhej nëpërmjet zhvillimit të punës paralelisht me dy sisteme. Pavarësisht avantazheve që paraqet CCMIS, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vlerësonte së Sistemi CCMIS/ICMIS, nuk ofron të gjitha elementet që ofron Sistemi ARK-IT. Sipas tyre, ARK-IT mundëson gjenerim më të saktë të statistikave dhe ofron shërbim online në informimin e palëve nëpërmjet faqes zyrtare të internetit.

- **Mirëmbajtja e portalit. Të dhënat personale**

Në takim u diskutuan edhe problemet e hasura nga Gjykatat me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky i fundit, shpeshherë u ka përcjellë shqetësimin lidhur me publikimin e të dhënave personale. Kjo problematikë vjen për shkak se sistemi nuk mund të realizojë në mënyrë teknike mospublikimin e disa të dhënave. Duke iu referuar edhe praktikës së vendeve europiane, si Gjermania, si rrugëzgjdhje mund të shihet caktimi i një personi përgjegjës pranë Gjykatës, i cili mund të realizojë manualisht bërjen anonime të të dhënave personale.

Shtimi i personelit me një punonjës për të bërë anonime këto të dhëna (p.sh. për të miturit) u rekomandua si i nevojshëm për arsye të pamundësisë për t'u realizuar nga sekretarja gjyqësore, për shkak të ngarkesës që paraqet realizimi i kësaj pune.



Kreu II

Rekomandime

1. Në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi dhe funksionimi i plotë i sistemit nevojitet hartimi i Rregullores së përdorimit të sistemit CCMIS/ICMIS, që do të përcaktonte detyrat për çdo përdorues. Aktualisht janë shpërndarë manualët e përdorimit të sistemit, por këto të fundit nuk përcaktojnë detyrimet e përdoruesve për zbatimin e procedurave të hedhjes të të dhënave dhe realizimit të funksionaliteteve përkatëse në sistem sipas roleve.
2. Caktimi i një personi përgjegjës për sistemin CCMIS/ICMIS pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mbledhjen e kërkesave, problematikave nga gjykatat, analizimin e tyre dhe më pas dërgimin tek kompania, e cila mirëmban sistemin CCMIS dhe ICMIS për realizim. Përditësimi i kërkesave sipas gjykatave duhet të bëhet në bazën e të dhënave qendrore për të pasur një unifikim të sistemit.
3. Sistem i unifikuar
Duhet patjetër një sistem i unifikuar i CCMIS dhe ARK-IT të kalojë në CCMIS. Nëpërmjet unifikimit mund të kemi edhe statusin e çështjes.
4. Mirëmbajtja e portalit. Të dhënat personale
Sistemi nuk mund të realizojë në mënyrë teknike mospublikimin e disa të dhënave personale, ndërsa manualisht mund të realizohet duke caktuar një person përgjegjës në Gjykatë. Ne rekomandojmë që të shtohet personeli me një punonjës për të bërë anonime këto të dhëna personale.
5. Për sa i përket problemeve teknike të hasura sugjerojmë se është i nevojshëm:
 - Transferimi i çështjeve nga arkiva e sistemit ARK-IT në sistemin CCMIS/ICMIS¹⁵.

¹⁵ Transferimi i çështjeve duhet të parashikohet për 6 gjykatat që kanë sistemin ARK-IT.

- Krijimi i fushave të detyrueshme në sistem, me qëllim gjenerimin e saktë të statistikave sipas standardeve të kërkuara. Në lidhje me këtë rekomandim është i nevojshëm bashkërendimi i punës me strukturat e teknologjisë së informacionit dhe statistikave.
 - Përmirësimi i infrastrukturës së komunikimit të sistemit CCMIS/ICMIS midis gjykatave për gjurmueshmërinë e çështjes sipas mënyrës së përfundimit (Shkalla e parë, Apel, Gjykatë e Lartë) dhe infrastrukturës së komunikimit me sistemet e tjera për lehtësi.
6. Trajnime të vazhdueshme për IT-të e gjykatave në lidhje me përmirësimet e sistemit CCMIS/ICMIS, të cilët do të trajnojnë më pas stafin e tyre të gjykatës. Mund të bëhet edhe një trajnim rajonal. Gjithashtu sugjerohet trajnim i plotë për IT, të cilët nuk kanë shumë njohuri mbi përdorimin e plotë të sistemit. Kjo do të sillte lehtësi në hasjen e problematikave të thjeshta gjatë përdorimit të sistemit, nga përdoruesit e tjerë të cilat mund të zgjidhen nga përdoruesi IT.
7. Shkëmbim eksperiencash midis IT-ve të gjykatave
- Në funksion të shmangies së problematikave që lindin gjatë përdorimit të sistemit dhe përmirësimit të mëtejshëm të përdorimit të tij, shkëmbimi i eksperiencave midis IT-ve të gjykatave do t'i shërbente zbatimit më me efektivitet të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Civile/Penale (CCMIS/ICMIS).